

LIGJ
Nr. 53/2022

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT
TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, për:

- a) organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në vijim “Autoriteti”;
- b) procedurat për refuzimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe certifikatave, legjislacionin e aplikueshëm në rastin e ankimimit të vendimeve të Autoritetit;
- c) llojet e tarifave për shërbimet që ofron, mënyrën e llogaritjes së tyre, mënyrën e administrimit të të ardhurave të realizuara prej tyre, si dhe rastet e përjashtimeve nga zbatimi i rregullave në fuqi dhe masat për ruajtjen e nivelit të sigurisë në këto raste.

Neni 2
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Autoriteti, si Autoritet Mbikëqyrës Kombëtar, ka në fushën e tij të veprimtarisë rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil, në zbatim të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë.

KREU II
STATUSI, ORGANET DREJTUESE DHE STRUKTURA E AUTORITETIT

Neni 3
Statusi i Autoritetit

Autoriteti është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, veprimtaria e të cilit është nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, në vijim “ministri”.

Neni 4
Organet drejtuese të Autoritetit

Organet drejtuese të Autoritetit janë këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv.

Neni 5
Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit.

2. Këshilli drejtues është organ kolegjal, i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, nga të cilët dy specialistë të fushës së transportit ajror, dy specialistë të fushës së financës dhe një specialist i fushës ligjore, të cilët duhet të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues emërohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 6

Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- a) miraton programet e zhvillimit të Autoritetit në përputhje me strategjinë e aviacionit civil;
- b) propozon te ministri strukturën organizative të Autoritetit, e cila miratohet me urdhër të Kryeministrit;
- c) miraton metodologjinë për përcaktimin e masës së trajtimeve të tjera financiare ose jofinanciare të administratës së Autoritetit, duke marrë në konsideratë kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitetet rregullator dhe nevojat e institucionit sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, ku parashikohen funksionet specifike dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe të sektorëve, sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe masat disiplinore që merren në raste shkeljeje nga punonjësit e Autoritetit, struktura përgjegjëse për marrjen e tyre, rastet/arsyet specifike për të cilat lind e drejta për vendosjen e secilës masë disiplinore përkatëse, si dhe procedura konkrete që ndiqet për vendosjen e tyre;
- d) miraton programin financiar të Autoritetit e ndryshimet dhe mbikëqyr realizimin e tij;
- dh) miraton rregullat për metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave dhe llojet e tarifave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti;
- e) propozon te ministri masën e tarifave që do të zbatohen nga Autoriteti sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe të ministrit të financave;
- ë) propozon te ministri kandidatët për t'u emëruar drejtorë ekzekutivë, si dhe propozon shkarkimin e tyre;
- f) i siguron drejtorit ekzekutiv udhëzime për veprimtarinë;
- g) miraton planin e veprimit, raportin vjetor dhe raporte të tjera të Autoritetit;
- gj) mbikëqyr punën e drejtorit ekzekutiv në drejtimin e Autoritetit;
- h) miraton pagat, si dhe nivelet e pagave të punonjësve të Autoritetit brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, si dhe shtesat e shpërblimet profesionale të punonjësve, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri;
- i) miraton shpërblimet dhe masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri;
- j) merr vendime për çështje të tjera në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

Neni 7

Kriteret e emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues

Për t'u emëruar kryetar ose anëtar i këshillit drejtues, personat duhet të plotësojnë këto kriterë:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

- c) të kenë përvojë të paktën 5 vjet në administratën publike, sektorin privat ose në institucionet shkencore arsimore;
- ç) të jenë me integritet moral dhe profesional;
- d) të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 5 vjetëve të fundit;
- dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;
- e) ndaj tyre të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues

1. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të këshillit drejtues është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
2. Kur mandati i kryetarit ose i anëtarit përfundon, ata qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e kryetarit ose të anëtarit të ri.
3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se një këshilli drejtues apo të një organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Neni 9

Shpërblimet e këshillit drejtues

Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues shpërblehen në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

Neni 10

Lirimi nga detyra e kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues

1. Lirimi nga detyra e kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues përpara përfundimit të mandatit bëhet, kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar për më shumë se 3 muaj;
 - c) kur mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;
 - ç) i shkakton për shkak të paaftësisë profesionale ose të neglizhencës dëm Autoritetit apo imazhit të këtij Autoriteti;
 - d) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e Autoritetit;
 - dh) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
 - e) humbet apo lë shtetësinë shqiptare;
 - ë) del ne pension.
2. Propozimi për lirim nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues i paraqitet ministrit nga vetë këshilli apo nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit, shoqëruar edhe me arsyet e provat për të cilat kërkohet ky lirim.
3. Ministri, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit.
4. Kur ndonjëri prej anëtarëve të këshillit drejtues lirohet nga detyra përpara përfundimit të mandatit, anëtari tjetër emërohet sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për emërimin e anëtarëve të këtij këshilli për një mandat 4-vjeçar (katërvjeçar).

Neni 11
Mbledhjet e këshillit drejtues

1. Mbledhjet e këshillit drejtues thirren me nismën e kryetarit, me kërkesën e secilit prej anëtarëve ose me kërkesë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit, si dhe me kërkesë të ministrit. Këshilli drejtues mbledhet të paktën një herë në dy muaj për të diskutuar e vendosur për rendin e ditës.

2. Mbledhjet e këshillit drejtues drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.

3. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Vendimet e këshillit drejtues merren me shumicë të thjeshtë. Në votim nuk lejohet abstenimi.

4. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e këshillit drejtues nënshkruhen nga kryetari.

Neni 12
Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

1. Këshilli drejtues miraton rregulloren për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit që disponon, si dhe afatet e kushtet për mbajtjen e kopjeve të njësuara të këtij dokumentacioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informimin publik.

2. Çdo vendim i këshillit drejtues publikohet në faqen e internetit të Autoritetit.

Neni 13
Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i Autoritetit, i cili emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

2. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues.

3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues pa të drejtë vote.

Neni 14
Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto përgjegjësi e detyra:

- a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit;
- b) paraqet për miratim në këshillin drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;
- c) paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomik-financiar të Autoritetit dhe çdo ndryshim të tij;
- ç) paraqet për miratim në këshillin drejtues vlerat e tarifave që do të zbatohen për të gjitha autorizimet, certifikimet dhe licencat që lëshon ky Autoritet;
- d) përfaqëson Autoritetin në marrëdhëniet me të tretët;
- dh) ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrat për të siguruar plotësimin e detyrimeve, që i janë ngarkuar Autoritetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe nënshkruan të gjitha autorizimet, lejet, licencat e kategorizimet;
- e) miraton programet e trajnimit dhe të kualifikimeve të stafit të Autoritetit, për të cilat informon këshillin drejtues. Në rast nevojë, kontraktton ekspertë të jashtëm të fushës së aviacionit civil;
- ë) miraton manuale dhe/ose procedura me karakter tekniko-operacional;

f) në fund të çdo tremujori, drejtori ekzekutiv i paraqet këshillit drejtues një raport për veprimtarinë e tij gjatë tremujorit; pasqyrat përkatëse për realizimin e treguesve financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planifikimit; një raport të hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, për rastet e refuzimit të licencave, për të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të tjera si nga operatorët, ashtu dhe nga konsumatorët që i janë paraqitur Autoritetit.

Neni 15

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- c) të ketë përvojë, të paktën 5 vjet, në aviacionin civil;
- ç) të ketë integritet moral dhe profesional;
- d) të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 5 viteve të fundit;
- dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;
- e) të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Lirimi nga detyra i drejtorit ekzekutiv

Ministri i propozon Kryeministrit lirim nga detyra të drejtorit ekzekutiv, në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) bëhet fizikisht i paaftë për më shumë se 3 muaj për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar;
- c) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm Autoritetit ose imazhit të institucionit;
- ç) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e Autoritetit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
- dh) humbet apo lë shtetësinë shqiptare;
- e) kur mbush moshën për pension.

KREU III

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Neni 17

Organizimi dhe detyrimet

1. Struktura dhe organika e Autoritetit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit pas konsultimit paraprak me institucionin përgjegjës për strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shtetërore.

2. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Autoritetit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

3. Rekrutimi i punonjësve të Autoritetit bëhet në bazë të kërkesave dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion, të miratuara nga këshilli drejtues dhe të përcaktuara në rregulloren e

brendshme. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për funksionimin e administratës.

4. Punonjësit e Autoritetit, që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar, i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës sipas përcaktimeve të Kodit Ajror.

5. Punonjësit e Autoritetit, që administrojnë dokumentacion apo të dhëna që parashikohen në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar, u nënshtrohen parashikimeve ligjore të këtij të fundit.

Neni 18

Të ardhurat e Autoritetit

1. Të ardhurat realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti, të cilat llogariten në bazë të kostos kur është e aplikueshme dhe në bazë të metodologjisë së përcaktuar në nenin 6, shkronja “dh”, të këtij ligji.

2. Të ardhurat e Autoritetit përfshijnë:

a) të ardhurat nga tarifat e rrugës (*en-route*), të cilat mblidhen dhe faturohen nga Eurokontrolli, në zbatim të marrëveshjes së përbashkët të lidhur për tarifat e rrugës (*en-route*);

b) të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, e cila merret nëpërmjet aeroportit;

c) të ardhurat nga autorizimet, licencimet dhe certifikimet e parashikuara në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë;

ç) të ardhurat nga sanksionet, në zbatim të legjislacionit për aviacionit civil;

d) të ardhura të tjera të lejuara, si: grantet, fondi rezervë dhe huat.

3. Pasqyrat financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, trajtime financiare dhe jofinanciare, shpenzime operative dhe investime të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, për të krijuar dhe mbajtur fondin e rezervës, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të aviacionit civil, si dhe shpenzime të tjera të nevojshme. Trajtimet financiare përfshijnë mbulimin e shpenzimeve të kryera në përmbushje të detyrës, pagesat për trajnimet profesionale, për sigurimin e jetës dhe shëndetit dhe të tjera të ngjashme.

Autoriteti mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punonjësit e tij. Përcaktimet e akteve nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë nen, nuk zbatohen për Autoritetin.

5. Autoriteti, për përdorimin e fondeve të veta, zbaton dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimet publike.

Neni 19

Buxheti

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

2. Drejtori ekzekutiv paraqet për miratim në këshillin drejtues propozimin e detajuar të programit financiar për vitin pasardhës, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit përkatës.

3. Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai.

Të ardhurat e vitit 2021, të papërdorura nga Autoriteti, do të jenë pjesë e buxhetit të Autoritetit.

Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura deri në fund të vitit mbarten dhe reflektohen në nivelin e shpenzimeve të vitit vijues dhe në fondin rezervë.

4. Fondi rezervë, për qëllime të këtij ligji, nënkupton fondin në të cilin alokohen të ardhura të papërdorura në vitin ushtrimor dhe të mbartura në vitin pasardhës, të cilat përdoren për rastet e financimit të shpenzimeve dhe/ose investimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të

parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së programit ekonomik dhe në rastet e mosrealizimit të të ardhurave për shkaqe të paparashikuara. Fondi duhet të plotësohet gradualisht dhe brenda 5 vjetëve duhet të arrijë nivelin mesatar të gjashtëmuajorëve të dytë të buxhetit të Autoritetit të tre vjetëve të fundit. Me arritjen e këtij niveli, teprica e të ardhurave derdhet çdo vit në buxhetin e shtetit.

Neni 20 **Kontabiliteti**

1. Autoriteti mban regjistrat kontabël në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kontabël të zbatueshme.

2. Regjistrat kontabël duhet të pasqyrojnë me saktësi, në çdo kohë, gjendjen financiare të Autoritetit.

3. Autoriteti përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas certifikimit nga audituesi ligjor.

Neni 21 **Raportimi dhe kontrolli**

1. Brenda muajit prill të vitit pasardhës, Autoriteti i paraqet ministrit:

a) një raport vjetor për veprimtarinë e tij, përfshirë të gjitha vendimet e marra nga këshilli drejtues;

b) pasqyrat financiare vjetore;

c) një raport për realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve;

ç) një raport për vendimet e marra për licencat e dhëna, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, për rastet e refuzimit të licencave apo për kërkesat e tjera, që i janë paraqitur Autoritetit, si dhe për të dhënat e regjistrave dhe rezultatin e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura.

2. Autoriteti i paraqet në çdo kohë ministrit, me kërkesë të tij, çdo informacion, raportim dhe të dhëna të tjera, që vlerësohen të nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të transportit ajror.

KREU IV KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 22 **Kodi etik dhe profesionalizmi**

1. Anëtarët e këshillit drejtues, drejtori ekzekutiv dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale të miratuara nga këshilli drejtues.

2. Kur vërehen shkelje të kodit të etikës ose mungesë profesionalizmi, merren masa disiplinore deri në lirim ose largimin nga detyra.

Neni 23 **Konfidencialiteti**

1. Të dhënat për veprimtarinë e subjekteve, që operojnë në fushën e aviacionit civil, të cilat i vihen në dispozicion Autoritetit, klasifikohen “konfidenciale” nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose reputacionin e subjektit.

2. Nuk janë “konfidenciale” të dhënat tregtare të siguruara nga subjektet, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera.

3. Anëtarët e këshillit drejtues, drejtori ekzekutiv dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t'i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë të dhënat “konfidenciale”.

4. Çdo informacion tjetër për të cilin punonjësit e Autoritetit kanë dijeni për shkak të funksionit dhe detyrave që kryejnë, duhet të administrohet prej tyre në përputhje me rregullat e brendshme dhe hierarkinë e raportimit në Autoritet.

5. Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirimin nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues ose largimin nga detyra të punonjësit të Autoritetit.

6. Detyrimi për konfidencialitetin dhe mospërhapjen e të dhënave shtrihet për punonjësit e Autoritetit dhe anëtarët e këshillit drejtues për një periudhë 2-vjeçare pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

KREU V KOMPETENCA E AUTORITETIT GJATË USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE MBIKËQYRËSE

Neni 24

Marrja e masave administrative ndaj subjekteve të treta

1. Drejtori ekzekutiv merr vendime për:

a) parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve, që përbëjnë shkelje të Kodit Ajror dhe të akteve ligjore të dala në zbatim të tij;

b) parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit;

c) shmangien e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit.

2. Drejtori ekzekutiv ka autoritet për të vendosur në mënyrë të menjëhershme kufizime të përkohshme ose të përhershme në operim dhe/ose masa administrative të një subjekti i certifikuar apo i licencuar nga Autoriteti në rastin e konstatimit të mospërputhshmërisë me kërkesat e certifikimit dhe/ose licencimit, ose në rastin e një problemi të pazgjidhur të sigurisë në aviacion.

Procedura për evidentimin dhe ndjekjen e mospërputhshmërisë në rastet e konstatuara më sipër miratohet nga ministri

3. Në vendimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni përcaktohen:

a) veprimet që duhet të kryejnë subjektet për të parandaluar dëmin apo për të korrigjuar gjendjen;

b) afatet për kryerjen e ndryshimeve apo për korrigjimin e veprimeve;

c) detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve në rastet kur veprimet bien në kundërshtim me ligjin.

4. Autoriteti, në përputhje me parashikimet e nenit 160 të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, mund të zbatojë masa administrative, vënien e gjobave.

Neni 25

Ankimi ndaj vendimeve të Autoritetit

1. Kundër vendimit të Autoritetit mund të bëhet ankim te ministri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi. Me kalimin e 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës te ministri, ankuesi mund të bëjë ankim sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

2. Në rast të pranimit të ankimit nga ministri dhe vendimmarrjes së tij, Autoriteti detyrohet të zbatojë dispozitivin e vendimmarrjes së ministrit.

3. Për trajtimin e ankesave zbatohen procedurat e Kodit të Procedurave Administrative.
4. Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të autoritetit, përveç kur Gjykata vendos ndryshe.

Neni 26
Përfshirjet

1. Autoriteti ka të drejtë të bëjë përfshirje nga zbatimi i rregullave në fuqi në rastet kur parashikohen në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të cilat lejojnë përfshirjet, me kusht që pas një vlerësimi të arrihet në konkluzionin që mospërputhshmëria dhe masat e marra do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie.
2. Drejtori ekzekutiv propozon te ministri udhëzimin për procedurën e aplikimit të përfshirjeve.

Neni 27
Licencat, lejet dhe certifikatat

1. Në ushtrimin e kompetencave të tij në lidhje me lejet, licencat dhe certifikimet, Autoriteti zbaton krahas legjislacionit të fushës, edhe legjislacionin në fuqi për licencimin.
2. Autoriteti ngarkohet të hartojë procedurat e detajuara, që do të zbatohen për dhënie, refuzim, pezullim apo revokim të çdo lejeje, certifikatë apo licence të parashikuara në Kodin Ajror dhe legjislacionin në fuqi

Neni 28
Inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil

1. Pajisja e inspektorëve të Autoritetit me kredenciale kryhet sipas rregullave të miratuara nga ministri.
2. Në zbatim të rregullave të miratuara nga ministri, drejtori ekzekutiv mund të pajisë inspektorët me kredenciale për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, duke iu dhënë atyre:
 - a) të drejtën e pakufizuar të hyrjes në avion, në lehtësirat e aviacionit dhe në dokumentacionin përkatës, siç kërkohet për ushtrimin e funksioneve të tyre;
 - b) të drejtën për të kryer auditime të sigurisë së aviacionit, periodike ose të rastësishme, inspektime dhe testime të sipërmarrjet apo subjektet, objekt mbikëqyrjeje, certifikimi dhe licencimi të Autoritetit, sipas parashikimeve të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - c) të drejtën për të mos i lejuar çdo personi që të ushtrojë të drejtat e një licence të aviacionit, certifikate të aviacionit ose dokumenti tjetër, kur ka dyshime të arsyeshme. Kjo e drejtë ushtrohet menjëherë ose nëpërmjet një procesi të përcaktuar, që duhet të aplikohet brenda një kohe të arsyeshme në përputhje me rregulloren e miratuar nga drejtori ekzekutiv.
3. Në kuptim të këtij neni, termi “kredencial” nënkupton llojin e kualifikimit të veçantë në lidhje me kompetencat e Autoritetit, i cili i jep mbajtësit të saj disa të drejta të caktuara dhe detyrime në përputhje me Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 29
Dispozitë kalimtare

Anëtarët e zgjedhur të këshillit drejtues dhe drejtori ekzekutiv do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe drejtorit të ri.

Neni 30
Shfuqizime

1. Ligji nr. 10 233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore në fuqi, të cilat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në daljen e akteve nënligjore në përputhje me Kodin Ajror.

Neni 31
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 16.6.2022.